Kur autori "vulos" panikun pa fakte!

Kodi i gazetarëve në nenin 13 përcakton në mënyrë të qartë se gazetarët duhet të bëjnë dallim ndërmjet fakteve dhe mendimeve, ndërmjet lajmit dhe komentit. Në tekstin që ea analizojmë, e gjithë kjo është ngatërruar, faktet dhe mendimet nuk janë ndarë, ndërsa në titulli është "vulosur" paniku i pa faktuar. Pastaj, nuk është aspak informacion relevant ai pa të paktën pa nuk ka dy burime.

"Në Shkup ngritet alarm, fëmijët mund të kidnapohen nga një grup kriminelësh?" Këtë titull mbanë informcioni i publikuar në media para katër vitesh e ku që në titull të tij ngrihen plotë dyshime pasi mbyllet me pikëpyetje dhe që në krye të herës, krijon pa-besueshmëri dhe panik pa nevojë te prindërit.



Teksti i publikuar në www.klankosova.tv, nuk ka autorë, ndërsa në brendi citohet një portal në gjuhën maqedonase që ka shkruar këtë informacion, e përcillet nga një portal shqiptar i regjistruar me veprimtari në Maqedoninë e Veriut.

Teksti i krijuar pa autorë, duket se target ka pasur vetëm klikimet, por jo edhe saktësinë rreth informimit. Mungojnë një sërë faktesh për besueshmërinë e të njetit. Nga ajo kohë, duke kërkuar në të dhëna nga Buletini i MPB-së, as aty nuk gjendet informata mbi këtë ndodhi as

në datë (7 Shtator 2016) kur është publikuar ky lajm, as një ditë para e as një ditë pas. Pastaj, në vedin tonë evidentohen 61 persona të zhdukur, prej të cilëve vetëm 5 janë fëmijë që kanë humbur shumë vite më parë.

Fotografia e vendosur ka fëmijë të komunitetit romë, ndërsa në tekst në asnjë moment nuk thuhet nëse këta fëmijë ishin rom ose jo, ndërsa me këtë media shkel të drejtat autoriale të fotografisë dhe keqpërdorë fëmijë tjerë vetëm për të përfituar pak më shumë pëlqime.

Në bredi të tekstit thuhet: "Në veturën Opel ka qenë një burrë dhe një grua të cilët për t'i mashtruar fëmijët ju kanë dhënë lojëra të ndryshme me të vetmin qëllim që këta fëmijë të futen në veturë". Nga këtu, mund të themi se autori anonim kostaton vetë që kanë qenë një burrë dhe grua dhe me veturë "Opel". Ai nuk thirret në burime se kush ia konfirmoi këtë, policia, vetë fëmijët, prindërit e tyre ose ndonjë dëshmitarë okular.

Më tej thuhet se njëri fëmijë gënjehet dhe afrohet deri te vetura, e pastaj burrit i ikë nga dora. Sërisht mungojnë faktet se kush e pa këtë ngjarje dhe autori anonim këtë e quan incident pa mos verifikuar asgjë nga "incidenti i tij".

> Në veturën Opel ka qenë një burrë dhe një grua të cilët për t'i mashtruar fëmijët ju kanë dhënë lojëra të ndryshme me të vetmin qëllim që këta fëmijë të futen në veturë.
>
> Në një moment, njëri fëmijë i vogël sa kishte arritur deri te vetura, shoferi i veturës kishte dashur që me forcë ta fus fëmijën në veturë. Gjatë këtij incidenti, fëmija kishte filluar që të bërtasë dhe shoferit i kishte ikur nga dora.

Vertetësia e lajmit zvogëlohet akoma më shumë kur ne pjesën e sipërme të lajmit raportohet për dy fëmijë 10 vjeçar ndërsa më poshtë citohet vetëm incidenti i një fëmije, minimumi duhet të ishte bërë një sqarim për fëmiun tjetër se çfarë ndodhi me atë, nuk u përmend në pjesën e dytë sepse ngjasojnë si dy histori të ndryshme të ngjitura me njëra tjetrën pa një përputhje logjike.

Autor:

Xhevat Limani, 17 vjeçare